




Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.12.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-3282/13, për z. Fatmir Gërvalla – Zyrtar Kryesor Financiar në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-3282/13, për z. Fatmir Gërvalla – Zyrtar Kryesor Financiar në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, dhe njëkohësisht pronar dhe person i autorizuar në biznesin privat N.T.P. “Elektro Teknik”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Gërvalla, së pari është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Në këtë takim, ai ka konfirmuar se ushtron funksionin e Zyrtarit Kryesor Financiar në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, dhe njëkohësisht është pronar dhe person i autorizuar në biznesin privat N.T.P. “Elektro Teknik”.

Zyrtari i lartë publik ka kuptuar situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, prandaj pas rekomandimit të Agjencisë, ka premtuar se do ta autorizoj një person të besueshëm për ta udhëhequr këtë biznes.

Ndërkohë, z. Gërvalla, ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve, (DPKI 03-4404/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar që kishte në biznesin privat N.T.P. "Elektro Technik" për të ushtruar funksionin publik si Zyrtarit Kryesor Financiar.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

